



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKA**  
**SKUPSTINA OPSTINE -SUVA REKA**

---



**RR E G U L L O R E**

**PËR**

**MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË**

**TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS**

Suharekë-2020

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, pika (a), nenit 15 pika (f), dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën 20.05.2020, miratoi këtë

**R R E G U L L O R E**  
**P Ë R**  
**MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË**  
**SUHAREKËS**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi:**

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm.

**Neni 2**

**Fushëveprimi:**

Kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe taksën për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm në juridiksionin e Komunës së Suharekës.

**Neni 3**

**Përkufizimet:**

3.1 **Mbeturina**- nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.

3.2 **Menaxhim i mbeturinave**-nënkupton aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndet të njeriut mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes se këtyre aktiviteteve.

3.3 **Operator**-nënkupton personin, i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.

- 3.4 **Licenca për menaxhimin e mbeturinave**-nënkupton leje me shkrim, e cila jepet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas ligjeve në fuqi.
- 3.5 **Person**-nënkupton personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 3.6 **Ripërdorim**-nënkupton çfarë do operimi, me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar
- 3.7 **Mbledhje**-nënkupton mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave duke për fshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 3.8 **Mbledhje e ndare**-nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik
- 3.9 **Prodhuesi i mbeturinës**-nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me paraprocesim përzjerje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 3.10 **Zotëruesi i mbeturinës**-nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën.
- 3.11 **Mbeturina komunale**-nënkupton mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
- 3.12 **Mbeturina e parrezikshme**-nënkupton mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 3.13 **Mbeturina komerciale**-nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit rekreacionit por nuk përfshihen mbeturinat industriale
- 3.14 **Mbeturina inerte**-nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:
- 3.14.1 mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
- 3.14.2 i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave si përfaqësore dhe nëntokësore
- 3.15 **Mbeturinë e vëllimshme**-nënkupton mbeturinat me për masa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largim të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.
- 3.16 **Qendra grumbulluese**-nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

## Neni 4

### Llojit e mbeturinave;

4.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:

4.1.1 Mbeturina komunale janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

4.1.2 mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

4.1.3 Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobilet.

4.1.4 Mbeturina nga konstruktiv-demolimet dhe mbeturina të tjera të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;

4.1.5 Bio-mbeturinë janë mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit;

4.2 Mbeturina komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

4.3 Mbeturina industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4.4 Mbeturina medicinale janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;

4.5 Mbeturinat shtazore-janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

## Neni 5

### Përfshirjet;

5.1 Nga kjo rregullore përfshihen mbeturinat në vijim:

5.1.1 mbeturinat e rrezikshme dhe

5.1.2 llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme

5.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent.

## Neni 6

### Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave:

6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

6.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.

6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

- 6.4. Autorizimi i operatorit që të beje mbledhjen e mbeturinave e dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë sipas nevojës.
- 3.5 Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
- 6.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave.
- 6.7 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
- 6.8 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (kompostimit shtëpiak etj.)
- 6.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
- 6.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.11 Faturimi i taksës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
- 6.12 Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të taksës mbi mbeturinat.
- 6.13 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësve të taksapaguesve për mbeturina.
- 6.14 Propozon taksën për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendit të Komunës.
- 6.15 Dorëzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues.
- 6.16 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.
- 6.17 Trajtimi i mbeturinave komunale nga konstruktiv - demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës
- 6.18 Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);

## Neni 7

### **Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave;**

- 7.1 Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:
- 7.1.1 **Konsumatorët e amvisërive:**
- 7.1.2 të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët dhe
- 7.1.3 të shërbyer sipas shërbimit derë më derë
- 7.2 **Konsumatorët komercialë/industrialë:**
- 7.2.1 dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese
- 7.2.2 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulëta të shërbimit
- 7.2.3 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit
- 7.3 **Konsumatorët Institucional:**
- 7.3.1 konsumatorët e vegjël institucionalë
- 7.3.2 konsumatorë të mesëm dhe të mëdhenj institucionalë
- 7.3.2 konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë
- 7.4 Detajizimi i mëtejshëm i këtyre kategorive gjendet në shtojcën A të kësaj rregulloreje.

## Neni 8

### Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave;

- 8.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,
- 8.2. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.
- 8.3. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
- 8.4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme)
- 8.5. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.
- 8.6. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.
- 8.7. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Suharekës t'ia dorëzojë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- 8.8 Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave ndërsa mbeturinat e rrezikshme, ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikatë mbledhëse apo në vendet e caktuara nga Komuna

## Neni 9

### Taksa mbi mbeturinat;

- 9.1. Faturimi i taksës së mbeturinave bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues.
- 9.2. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave për çdo muaj të vitit.
- 9.3. Gjeneruesi i mbeturinave mund të paguaj faturën e taksës së mbeturinave, në katër këste brenda vitit, si më poshtë:
  - 9.3.1 Kësti i parë Janar – Mars
  - 9.3.2 Kësti i dytë Prill – Qershor
  - 9.3.3 Kësti i tretë Korrik- Shtator
  - 9.3.4 Kësti i katërt Tetor – Dhjetor.
- 9.4. Pagesa e taksës për mbeturinat, në shumën deri në **10 €** bëhet në arkën e komunës në Qendrën e Shërbimit me Qytetarëve, kurse në shumën mbi **10 €** bëhet në cilën do bankë.
- 9.5 Të gjitha familjet që janë me asistenc sociale lirohen nga pagesa e mbeturinave.

## Neni 10

### Kushtëzimi i ofrimit të shërbimit;

- 10.1 Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i pagunë 2 këste të njëpasnjëshme, nuk do të merr shërbime komunale administrative si më poshtë:
  - 10.1.1 Shërbime nga Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër,
  - 10.1.2 Shërbime nga Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim
  - 10.1.3 Shërbimet nga Drejtoria për shërbime publike, mjedis dhe emergjencë
  - 10.1.4 Shërbimet nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet

10.1.5 Shërbime nga Drejtoria për Inspeksionit

10.1.6 Shërbimet nga zyra e Prokurimit.

10.2. Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë: Shkalla e taksës do të rishikohet çdo dy vjet dhe atë në muajin shtator nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.

10.3 Kur Kuvendi Komunal në Suharekë miraton shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

10.4 Tarifa fillestare e taksës për mbeturina adapton tarifën e mbeturinave të përdorur në Vitinë 2020 siç është bashkangjitur në shtojcën A (shkalla e taksës për mbeturina).

10.5 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për tu ofrohet institucioneve dhe bizneset e mëdha të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

### **Neni 11**

#### **Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave;**

11.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe konform kësaj rregulloreje.

### **Neni 12**

#### **Veprimet e ndaluara;**

12.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë;

12.1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

12.1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është parapare;

12.1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave etj);

12.1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;

12.1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

12.1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike);

12.1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

12.1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;

12.1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme, nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;

12.1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";

12.1.11 Gërmimi, përzieja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar.

- 12.1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 12.1.13 Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 12.1.14 Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponin të mbeturinave;
- 12.1.15 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.

### Neni 13

#### Dispozitat Ndëshkuese - Gjrobat;

13.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbauesve privatë.

13.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjobë mandatorë sipas udhëzimit administrativ MMPH Nr. 06/2018 për ndëshkimet me gjoba mandatorë, sipas Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011"

#### DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 14

14.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetentë Inspekcioni Mjedisor i organit komunal përkatës, si dhe Policia e Kosovës.

14.2 Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës

### Neni 15

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet ne procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

### Neni 16

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, kjo rregullore hynë ne fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 110-18191  
Me data 21.05.2020



Kryesuesi i Kuvendit

**Bexhet KUÇI**

## SHTOJCA A:

Tarifa e taksës për mbeturina;

### LISTA E KONSUMATOREVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (MUJORE) PËR VITIN 2020

#### I. Kategoria amviseri : Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët

Tarifat mujore	Tarifa 4.50 euro	Tarifa 1.00 euro
Kategoritë	Amvisëri rezident	Amvisëri jo rezident (mërgimtarët)

#### II. KATEGORIA E KONSUMATOREVE KOMERCIAL / INDUSTRIAL :

*Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët*

Zona e Parë (A)	Zona e dytë (B)	Zona e tretë (C)
Suharekë	Sopijë	Stravuqin
Shirokë	Savrovë	Krushicë e ulët
Reshtan	Bukosh	Budakovë
	Vraniq	Krushicë e epërme
	Reqan	Mohlan
	Mushtisht	Doberdelan
	Dubravë	Nishor
	Sallagrazhd	Kasterc
	Grejkoc	Delloç
	Gjinoc	Maqitevë
	Gelancë	Papaz
	Leshan	Vërshëc
	Tërrnje	Qadrak
	Nepërbisht	Grejqevc
	Samadrexhë	Luzhnicë
	Studenqan	Breshanc
	Semetisht	
	Peqan	
	Bukosh	
	Bllacë	
	Duhël	
	Sllapuzhan	
	Dvoran	
	Populan	

I. Tarifa mujore	II. Tarifa mujore	III. Tarifa mujore	IV. Tarifa mujore	V. Tarifa mujore
Zona A: 5.20 euro Zona B: 4.50 euro Zona C : 3.50 euro	Zona A: 7.00 euro Zona B: 5.50 euro Zona C: 4.00 euro	Zona A: 9.00 euro Zona B: 6.00 euro Zona C: 5.20 euro	Zona A:12.15 euro Zona B: 10.00 euro Zona C: 6.00 euro	Zona A: 21.46 euro Zona B: 15.00 euro Zona C: 10.00 euro
Avokaturat Zyre tjera Agjencionet Bizhuteritë Argjendarit Optika Çajtoret Kozmetikët Këpuçarët Ortarët Farkëtarët Kafe pjekësit Video lojërat Kurset e gjuhëve Kiosqet Fotografistët Auto parkingjet Auto larjet Rrobaqepëse Këmbimoret	Kompanitë sigurimeve Auto shkollat Frizerët Mobil shop Kompjuter shop Auto elektrikist Auto mekanik Auto veglat Barnatore bujqesore Auto pjesë Librarit Elektro material Vullkanizer Bastoret Hekurishtet Zdrukthëtarët Servis teknikes bardh Parkingjet	Butikët Barnatoret Dyqanet e këpucëve Sanitarit Laboratorët Mini market Dyqanet Tekstil Sallonet e perdeve Sallone teknike bardh Pllacet ndërtimore	Kafiterit Ëmbëltoret Qebaptoret Byrektoret Gjellëtoret Piceritë Marketet Motelet Pompë benzinës (vetëm pompë) Sallonet e tepihëve Mobilierit Kazinetë Ordinancat Depot e pijeve Depot ushqimore	Restorantet Hotelet Furrat Pompa Benzinës – me objekt përcjellës
Çmimet sipas zbrazeve				
Vëllimi i Kontinerit	1.1 m <sup>3</sup>	5.0 m <sup>3</sup>	7.0 m <sup>3</sup>	
Tarifa (Euro/zbraze)	11.30 euro	Nuk ka të tillë	47.0 euro	

Vërejtje: kontinieri 1.1 m<sup>3</sup> x 60.00 euro për një zbraze është për mishtore dhe xhampresa.

### III. Kategoria e konsumatorëve Institucional.

Tarifa mujore 5.20 euro	Tarifa mujore 12.15 euro	Tarifa mujore 21.46 euro	Tarifat mujore 1 kontenier 1.1 m <sup>3</sup> (45.00 euro )
Zyre e partive Politike, Përfaqësitë të shoqatave, Objekte fetare	Teatër Galeri e arteve Biblioteka Çerdhe	Bankat Mikro financat Institucionet Financiar Zyre postare Keds Kost Hidroregjioni Të ngjashme	Objektet Komunale Ambulancat Shkollat Gjykatat Posta Policia Qendra regjistrimit (qkrc) Stacioni autobusëve Salla sportive
Shërbimet e ofruara me kontenjerë të veçantë			
Vëllimi I kontenjerit	1.1 m <sup>3</sup>	5.0 m <sup>3</sup>	7.0 m <sup>3</sup>
Tarifa (euro/zbraze)	11.30 euro	Nuk ka te tilla	47.00 euro